

**STATUTI  
I SHOQËRISË PRIVATE ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR  
“Sildi Hoxha”**

Sot me date 26/12/2023 Shoqëria tregtare private me përgjegjësi të kufizuar “**Sildi Hoxha**”, që këtu e më poshtë do të quhet “Shoqëria”, zotërohet nga ortaku:

Sildi Hoxha i datëlindjes 25/02/1994 shtetas shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në Tirane, i cili identifikohet me karte identiteti me numër personal J40225060C

Te cilet në përputhje me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë miratojnë statutin e shoqërisë “**Sildi Hoxha**”, në bazë të parimeve të mëposhtme:

**KAPITULLI I  
EMRI, FORMA, BAZA JURIDIKE,  
SELIA, TERRITORI**

**NENI 1  
FORMA DHE EMRI**

1.1 Shoqëria ka formën e shoqërise me përgjegjësi të kufizuar, me iniciale Sh.P.K., të cilat vijnë përpara ose menjëhere pas emrit të shoqërise. Kjo shoqëri i përballon humbjet deri në kufirin maksimal të vlerës së kontributit të ortakëve në kapitalin themeltar të shoqërise.

1.2 Emri i shoqërise është “**Sildi Hoxha**”, forma dhe emri i shoqërisë mund të ndryshohen me vendim të asamblesë së përgjithshme të ortakëve.

**NENI 2  
BAZA LIGJORE**

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me Ligjin Nr. 9723,



datë 03.05.2007 dhe Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithsi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe që do të ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

NENI 3  
SELIA

Selia e shoqërisë është në adresën: **Rruga "Sulejman Delvina", Zona kadastrale Nr. 8270, Nr. Pasurie 2/400, Tirane**

Me adresën e mësipërme do të identifikohet qendra e personit juridik. Me vendim të asamblesë së ortakëve mund të hapen degë, filiale, agjensi ose përfaqësi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë sipas fushave në të cilat e ushtron veprimtarinë shoqëria.

NENI 4  
TERRITORI

4.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj lirisht si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërise.

4.2 Shoqëria mund të krijojë zyra ose përfaqësi të saj brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërise. Zyra, filiale ose përfaqesite e shoqërise jashtë territorit të Republikës së Shqipërise do të krijohen dhe do të zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

**KAPITULLI II**  
**OBJEKTI DHE KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

NENI 5  
OBJEKTI I VEPRIMTARISË

5. Shoqëria “Sildi Hoxha”, është e organizuar në formën e një shoqërie të prodhimit dhe tregtimit në të gjithë komponentët e saj dhe ka si objekt kryesor të veprimtarisë së saj:

Pergatitja dhe mirembajtja e faqeve te internetit, sherbimeve te telekomunikacionit, pergatitja dhe mirembajtja e rrjeteve sociale ne internet si dhe marketing online, mirembajtja dhe riparimi i kompjuterave dhe rrjeteve te komunikimit si dhe sherbime te tjera informatike. Hartim dhe implementim projektesh ne fushen e teknologjise se informacionit. Zhvillim software, 2 platforma dixhitale, ecommerce dhe shitja e programeve kompjuterike per perdonim ne fusha te ndryshme. Ofrimi i sherbimeve te ndryshme informatike ne fushen e teknologjise se informacionit, konsulenca ne lidhje me aplikimin e teknologjise se informacionit ne fusha te

---



ndryshme.

Lidhur me aktivitetin e përmendur me sipër, ne përputhje me legjislacionin ne fuqi, mbetet e kuptuar se detyra te tilla profesionale do t'i ngarkohen drejtëpërdrejt profesionistëve, rregullisht te aktivizuar ne varësi te rastit, nën përgjegjësinë e tyre.

5.4 Me qëllim arritjen e objektit të saj, shoqëria me vendim të organit kompetent, mund të zotëroje në mënyre të drejtpërdrejte apo të tërthortë pjesëmarrje në shoqëri apo ndërmarrje të tjera, shqiptare apo të huaja, të cilat kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo ndihmës me të. Pjesmarrja në shoqëri që për llojin e tyre nuk ofrojnë përgjegjësi të kufizuar, miratohet paraprakisht nga asambleja e ortakëve.

**NENI 6**  
**KOHËZGJATJA**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat të papercaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit në organin kompetent. Shoqëria prishet dhe kalon në procedurë likujdimi me vendim të asamblese së ortakeve, si dhe në rastet e tjera të parashikuara në ligj.

**KAPITULLI III**

**LIBRI I SHOQËRISË, KONFIDENCIALITETI, DOKUMENTET E  
DISTINUARA PER TË TRETËT**

**NENI 7**  
**LIBRI I SHOQËRISË**

Për të saktësuar veprimtarine e vet ekonomike si dhe marredhëniet e punës, shoqëria do të çelë librin e vet, i cili do të quhet libri i shoqërisë.

**NENI 8**  
**KONFIDENCIALITETI**

Ortakët e shoqërise si dhe personat e tjere të pranuar në shoqëri, bien dakord që të mos i ekspozojnë asnjë personi të jashtëm informacionet që do të disponojë shoqëria, kontratat që ajo do të lidhe, çdo lloj materiali, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen e saj.

**NENI 9**  
**DOKUMENTET E DESTINUARA PËR TË TRETËT**

Të gjithë aktet dhe dokumentet që nxirren nga shoqëria dhe të destinuara për të tretët, si letrat, faturat, lajmërimet dhe publikimet e ndryshme etj., duhet të tregojnë

---



lexueshmëm emrin e shoqërisë dhe pas tij fjalët "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose inicialet "Sh.P.K.", si dhe emrin e administratorit ose te administratorëve.

## **KAPITULLI IV**

### **KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJSËT DHE TRASFERIMI I TYRE**

#### **NENI 10 KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar i shoqërise është : 100,000 Lek ( Njeqindmije lek), zoterues i një kuote me 100% te aksioneve ortaku Sildi Hoxha

Kapitali themeltar i shoqërise është shlyer tërësisht dhe depozituar ne një llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dytë.

#### **NENI 11 TË DREJTAT E ORTAKËVE NË LIDHJE ME KAPITALIN**

11.1 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar të shoqërise kryhet sipas vendimit të asamblese së përgjithshme të ortakeve, me shumicën e (tre të katërtave) të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërise.

11.2 Përgjegjësia e ortakeve për detyrimet e shoqërise shtrihet deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin e saj themeltar.

11.3 Kuotat e kapitalit të shoqërise mund të rëndohen lirisht me barrë siguruese apo të drejta të tjera reale. Në rast shitje të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërise për efekt zbatimi të një vendimi gjyqësor apo përbushje të një detyrimi, enti që ekzekuton vendimin ose detyrimin (zyra permbarimore ose ndonje organ tjeter kompetent), duhet te kete në konsiderate respektimin e kërkesave të nenit 14 të këtij statuti. Secili ortak që rëndon me barrë apo të drejta të tjera reale kuotat e tij, ka detyrimin ti shpjegoje nenin 14 të këtij statuti subjektit në favor të cilit vendoset barra siguruese.

11.4 Secili ortak ushtron të drejtat pasurore të parashikuara nga ligji në proporcion me kuotat e pjesëmarrjes në kapital.

11.5 Ortakët që nuk marrin pjese në administrimin e shoqërisë kanë të drejtë t'i kërkojnë organit administrativ informacione mbi aktivitetin e shoqërisë, si dhe të konsultojnë dokumentet kontabël e dokumentet e tjera që lidhen me administrimin e saj.

#### **NENI 12**



## FUSHA E AUTORITETIT TE ORTAKUT

Fusha e autoritetit të ortakëve, përqindja e fitimeve ose humbjeve do të kenë si kriter bazë kontributin e çdo ortaku ne kapitalin e shoqërisë, si dhe kompetencat që gëzon ortaku në marrjen e vendimeve të çdo karakteri, të përcaktuar në këtë statut.

### NENI 13 FINANCIMI I SHOQËRISË

13.1 Organi administrativ, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ka të drejtë të kërkojë nga ortaket fondet e nevojshme për arritjen e objektit të shoqërisë.

13.2 Financimet e mëtejshme të ortakeve do të janë me shpërblim (interesa) apo pa shpërblim, në varësi të titullit nepërmjet të cilit jepen këto fonde.

### NENI 14 LENIA DHE TRASFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT

14.1 Kapitali themeltar i shoqërisë ose pjesë të tij mund të trasferohen lirisht mes ortakëve të shoqërisë. Kapitali themeltar i shoqërisë ose pjesë të tij mund të trasferohen tek persona të tretë vetëm pasi ortakët e shoqërisë në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar zyrtarisht kanë refuzuar ushtrimin e të drejtës sëparablerjes.

14.2 Trasferimi i kapitalit themeltar të shoqërisë ose i pjesëve të tij tek persona të tretë bëhet vetëm në këtë menyrë:

- Oferta për shitje u drejtohet të gjithe ortakëve me shkrim;
  - Oferta duhet të përcaktoje numrin e kuotave që shiten dhe çmimin e tyre;
- Nëse ortakët e shoqërisë brënda tre muajsh nga oferta me shkrim nuk pranojnë blerjen e kuotave të ofruara me çmimin e kërkuar, atëherë ata konsiderohet se lejojnë shitblerjen tek të tretët.

14.3 Kapitali themeltar është lirisht i trashegueshëm në rrugë trashigimie. Bashkshorti, paraardhesit mund të bëhen ortakë nepërmjet trasferimit të pjesëve të kapitalit themeltar sipas kushteve që lejohen në ligj.

14.4 Trasferimet e pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vertetohen me akt notarial dhe të depozitohen në organin kompetent.

### **KAPITULLI V** **ORGANET DREJTUESE DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

### NENI 15 ORGANET DREJTUESE



---

15.1 Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë asambleja e ortakëve dhe administratori. Për efekt të ndryshimeve që mund të pësojë shoqëria në të ardhmen dhe shtimit të numrit të ortakeve, këtu e në vazhdim organit zotëruesh të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë do ti referohemi me termin Asamble e Ortakëve.

15.2 Shoqëria mund të emërojë më shumë se një administrator. Në çdo rast, kur termi "Administrator" përdoret për të përcaktuar administratorin e shoqërisë "Sildi Hoxha" ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numër.

15.3 Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohëzgjatja dhe kompetencat e tyre.

15.4 Administrator i shoqerise për një periudhë 5 (pesë) vjeçare është Sildi Hoxha i datëlindjes 25/02/1994 shtetas shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në Tirane, i cili identifikohet me karte identiteti me numër personal J40225060C

## **KAPITULLI VI** **ASAMBLEJA E ORTAKËVE**

### **NENI 16** **VENDIMET E ASAMBLESË TE ORTAKËVE**

16.1 Asambleja e ortakëve vendos për çështjet që ligji apo ky statut ia rezervon këtij organi, si dhe për çështjet për të cilat, organi administrativ kërkon mendimin apo miratimin e ortakëve.

16.2 Vendimet e zakonshme të asamblesë së ortakëve merren me votën e ortakëve që zoterojnë më shumë se gjysmën e kuotave të kapitalit themeltar, përveç rasteve kur ligji apo statuti kërkon një shumicë të ndryshme.

16.3 Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqerinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### **NENI 17** **KONSULTIMI ME SHKRIM I ORTAKËVE**

17.1 Në përputhje me dispozitat e statutit, vendimet e ortakëve mund të merren pas një konsultimi me shkrim që organi administrativ i drejton secilit prej tyre. Në këtë rast, organi administrativ i komunikon ortakëve tekstin e projekt-vendimit që do të merret dhe i kërkon të shprehin vullnetin e tyre në lidhje me këte çështje.

17.2 Vendimet e marra në këte menyrë janë të vlefshme kur vendimi merret nga shumica që ligji apo ky statut kërkon për atë çështje.

### **NENI 18** **MËNYRA DHE VENDI I THIRRJES SË ASAMBLESË SË ORTAKËVE**

18.1 Asambleja e ortakëve thirret pranë selisë së shoqërisë, apo në ndonjë vend tjetër



brënda apo jashtë Shqipërisë, nepërmjet një njoftimi me shkrim që iu dërgohet ortakëve nga kryetari i asamblesë së ortakëve dhe/ose organi administrativ në e-mail:

- “**sildihoxha11@gmail.com**” dhe në numër telefoni **0693122655**

18.2 Njoftimi i thirrjes së mbledhjes së asamblesë duhet të kryhet 15(pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së mbledhjes dhe duhet të përcaktojë shprehimisht datën, orën, vandin si dhe rendin e ditës. Në rast pamundësie apo mosveprimi nga ana e organit administrativ, mbledhja e asamblesë së ortakëve mund të thirret nga esperti kontabël i autorizuar, nëse ka të tillë, ose nga një apo më shumë ortakë, të cilët përfaqësojnë jo më pak se 10% të kapitalit të shoqerisë.

### **NENI 19 KRYETARI I MBLEDHJES SE ASAMBLESË SË ORTAKËVE**

19.1 Mbledhja e asamblesë së ortakeve emëron kryetarin e asamblesë.

19.2 Kryetari i asamblesë verifikon thirrjen dhe mbledhjen e rregullt të asamblesë së ortakëve, vërteton identitetin apo legjitimimin e përfaqësuesit të ortakëve dhe drejton zhvillimin e rregullt të mbledhjes.

### **NENI 20 PJESEMARRJA NE VENDIME**

Çdo ortak ka të drejten e një vote për cdo kuotë të kapitalit themeltar të shoqërisë që ai zotëron. Një ortak mund të përfaqësohet në mbledhjen e asamblesë nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë, nepërmjet një akti përfaqësimi me shkrim.

### **NENI 21 KOMPETENCAT E ASAMBLESË SË ORTAKËVE**

21.1 Asambleja e ortakëve mund të jetë e zakonshme dhe e jashtëzakonshme, kjo në varësi të çështjes për të cilën është thirrur. Vendimet e asamblesë së zakonshme të ortakëve merren vetëm nësë marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave. Vendimet e asamblesë së jashtëzakonshme të ortakëve merren me një shumice të cilësuar prej 3/4 të votave të ortakëve të shoqërisë. Për cfarë nuk është pasqyruar në këtë nen, asambleja e ortakëve të shoqërisë vendos në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, i ndryshuar.

---



## 21.2 Kompetencat e asamblesë së zakonshme të ortakëve do të janë:

- Vendos për përpilimin ose miratimin e rregulloreve për shoqërime apo përfusha e vecanta të veprimtarisë.
- Vendos për ndryshimin e selisë së shoqërisë.
- Vendos për krijimin e zyrave ose të përfaqësive si dhe përkrijimin e shoqërise ose të ortakërise me persona të tjere fizike apo juridike.
- Vendos për politiken afariste të shoqërisë dhe përcakton fushat konkrete te veprimtarise së saj.
- Emëron dhe shkarkon me një shumice të cilësuar prej 3/4 të votave të ortakëve të shoqërisë : administratorin e shoqërise, ekspertin kontabël, likujdatorin duke përcaktuar dhe detajuar kompetencat e tyre, të drejtat, detyrimet, kohëzgjatjen në detyrë, dhe shpërblimin e tyre.
- Vendos në lidhje me krijimin e organeve të tjera drejtuese që mund ti nevojiten shoqërisë duke përcaktuar në aktet e krijimit të këtyre organeve, kohëzgjatjen dhe kompetencat e tyre, për emerimin e personave drejtues të ketyre organeve.
- Asambleja e ortakëve marrjen e vendimeve e kryen vetë dhe nuk bën delegimin e vendimarrjes te asnjë organ tjeter. Asambleja e ortakëve vendos edhe në lidhje me krijimin e sektorëve te veçante të veprimtarisë së shoqërisë.
- Shqyrtton dhe miraton bilancin vjetor, përcakton llojin e fondeve te ndryshme dhe masen e tyre, përcaktimin e dividentit, marrjen dhe dhenien e huave, kredive, borxheve.
- Realizon marrëdhieniet më të rëndësishme ekonomike dhe financiare të shoqërisë me persona te tjere fizik apo juridik, vendas apo te huaj.
- Miraton një tabele për tarifat e shërbimeve të shoqërise sipas fushave
- Vendos në lidhje me transferimin e pjesave te kapitalit themeltar te shoqërise.

## 21.3 Kompetencat e asamblesë së jashtëzakonshme të ortakeve janë:

- Vendos në lidhje me zmadhimin dhe zvogelinin e kapitalit themeltar të shoqërisë.
- Vendos në lidhje me kohëzgjatjen e shoqërise si dhe për mbarimin e likujdimin e saj.
- Vendos për ndryshimin e emrit të shoqërisë.
- Vendos në lidhje me ndryshimin e statutit të shoqërisë.
- Vendos për ndryshimin e formës, për ndarjen e shoqërisë si dhe përbashkimin e saj me shoqëri të tjera.

## 21.4 Përveç kompetencave të lartëpërmendura, të cilat jane ekskluzive për të, asambleja e ortakëve ushtron çdo kompetencë që ia njeh ligji.

## 21.5 Asambleja e ortakëve në rastet kur nuk ka emëruar administrator, kryen dhe kompetencat që në këtë statut janë përcaktuar për këtë të fundit. Gjithashtu, asambleja e ortakëve mund të kufizoje administratorin në ushtrimin e kompetencave të tij.

**NENI 22**  
**ADMINISTRATORI DHE KOMPETENCAT E TIJ**

22.1 Kompetencat e administratorit ose të administratoreve, në mënyre konkrete dhe të detajuar përcaktohen në aktin e tyre të emerimit. Veç të tjerave që mund të detajohen në këtë akt, administratori ka edhe këto kompetenca:

- Kujdeset përfunksionimin e përditshem normal të shoqërise ose të një pjese të aktivitetit ekonomik dhe financiar të saj, sipas përcaktimit në aktin e emerimit.
- Përgatit dokumentacionin dhe raportet e ndryshme për gjendjen ekonomike dhe financiare te shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi dhe ia paraqet asamblesë së ortakëve për shqyrtim.
- Kordinon veprimtarinë e personave të punesuar në shoqëri.
- Ndjek problemet e shoqërise në marredhenie me organet shtetërore ose cakton ndonjë prej personelit për trajtimin e këtyre problemeve.
- I propozon asamblesë së ortakëve tarifat e shërbimeve dhe pagat per personelin e punësuar në shoqëri.
- I propozon asmblesë së ortakëve rregulloren e shoqërisë.
- Administratoret kanë të drejtë të gjithë sëbashku ose veçmas nga njeri tjetri të përfaqësojnë shoqërinë në lidhje me të tretët.

22.2 Administratori ose administratorët janë përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve qoftë për shkelje ligjore, qoftë për shkelje të statutit ose përfajra të kryera gjatë ushtrimit të administrimit të shoqërisë. Përgjegjësia është individuale ose solidare, kjo në varësi të rr Ethanave dhe të mënyrës sesi është vepruar, pra individualisht ose solidarisht.

**KAPITULLI VII**

**LIBRAT E SHOQËRISË, BILANCI, DIVIDENTET, KONTROLLI  
KONTABËL**

**NENI 23**  
**KONTROLLI KONTABËL**

Kontrolli i jashtëm kontabël i shoqërisë kryhet nga ekspertë kontabël të autorizuar, sipas legjislacionit në fuqi. Asambleja e ortakëve do të emeroje një apo më shumë eksperte kontabël në ato raste kur emerimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërcohët në bazë të ligjit.

**NENI 24**  
**LIBRAT E SHOQËRISË**



Shoqëria është e detyruar të mbaje, përveç librit të shoqërisë, në të cilin shënohen emrat e plotë të ortakeve dhe kapitali themeltar, si dhe vendimet e asamblesë së ortakëve, edhe dokumentacionin kontabël dhe librat e tjera.

#### NENI 25 BILANCI DHE REZERVAT

25.1 Bilanci mbylljet ne 31 dhjetor të çdo viti. Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiare dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabel i autorizuar, i paraqiten per shqyrtim asamblese se ortakeve, e cila vendos mbi miratimin, ndryshimin ose rrezimin e ketyre akteve, kur e konsideron te nevojshme asambleja e ortakeve mund te beje rekomandimet e nevojshme ne lidhje me çeshtjen ne diskutim.

25.2 Me mbylljen e secilit vit financiar, administratori i vetem merr masat e nevojshme per hartimin e projekt-bilancit te aktivitetit per vitin financiar te mbyllur, ne menyre qe asambleja e ortakeve te vendose mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme te tij brenda afateve te percaktuara nga ligji.

25.3 Asambleja e ortakeve vendos mbi ndarjen ndërmjet ortakëve të shumave që rezultojne si fitime sipas bilancit të aprovuar rregullisht, pasi nga këto shuma të jenë zbritur humbjet e mundshme të viteve të mëparshme, si dhe të jenë lëne mënjanë shumat e nevojshme për krijimine rezervës ligjore. Rezerva ligjore krijohet vit pas viti nepërmjet lënies mënjanë të një shume të barabarte me 5 % të fitimit neto të realizuar gjatë secilit vit financiar, deri sa të arrihet një shume e barabartë me 10 % te kapitalit themeltar të shoqërisë.

25.4 Asambleja e ortakëve në çdo moment mund të vendosë krijimin e rezervave të tjera, si dhe masen e tyre.


#### KAPITULLI VIII **MBARIMI DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË**

#### NENI 26 MBARIMI

Shoqëria mbaron me vendim të asamblesë së jashtëzakonshme të ortakeve ose kur ka nje prishje të parakohshme për arsyet e parashikuara në ligj.

#### NENI 27 LIKUJDIMI

27.1 Shoqëria hyn në procesin e likujdimit që në momentin e prishjes së saj. Për



kryerjen e këtij procesi asambleja e ortakeve cakton një ose disa likujdues, të cilët i paraqesin asaj reportin mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit të shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve të likujdimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.

27.2 Në fund të procesit të likujdimit, asambleja e ortakeve vendos mbi bilancin përfundimtar financier dhe mbi mylljen e proçesit të likujdimit.

27.3 Mbas pagimit të kreditoreve asambleja e ortakëve mban pjesën e mbetur të kapitalit që u shperndahet ortakëve.

## **KAPITULLI IX** **MOSMARRËVESHJET DHE DISPOZITA TË FUNDIT**

### **NENI 28** **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

Çdo mosmarreveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likujdimin e kësaj shoqërie, ortakët do të angazhohen se do ta zgjidhin me mirëkuptim, dhe ne rast se kjo nuk arrihet gjykata kompetente për gjykimin e mosmarreveshjeve apo konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane

### **NENI 29** **DISPOZITA TE FUNDIT**

29.1 Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe me ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë statut, do të aplikohen dispozitat e legjispcionit shqiptarë në fushën e shoqërive tregtare si dhe legjisacioni shqiptar në përgjithësi.

29.2 Ky statut është hartuar ne 2 (Dy) ekzemplare, në gjuhën shqipe, duke patur secili ekzemplare fuqi të njëjtë ligjore.

**“Sildi Hoxha”**

Ortaku  
Sildi Hoxha

*Sildi Hoxha*  
*Rufi*